

PRAKTIKAT MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE: SANKSIONET SPECIFIKE FINANCIARE QË LIDHEN ME TERRORIZMIN DHE
FINANCIMIN E TERRORIZMIT(REKOMANDIMI 6)

Udhëzuesi i Rekomandimit 6 të FATF-ës

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET

Rëndësia e një regjimi efektiv ngrirës

I. AUTORITETET DHE PROCEDURAT E DUHURA PËR IDENTIFIKIMIN DHE SHPALLJEN E PERSONAVE OSE SUBJEKTEVE

- A. Shpallja e personave dhe subjekteve
- B. Masat gjyqësore ose administrative nuk kushtëzohen nga ekzistenca e procedurave penale
- C. Standardet e provës: shkaqet ose bazat e arsyeshme
- D. Identifikimi i informacionit
- E. Autoritetet për të identifikuar, shpallur dhe sanksionuar
- F. Identifikimi i objektivave për shpallje
- G. Përdorimi i materialeve të inteligjencës dhe burimeve të mbyllura
- H. Kuptimi i termit “pa vonesë” në kontekstin e shpalljeve

II. PROCESI I DUHUR I : RISHIKIMIT, DELISTIMI DHE SHKRIRJA

- A. Njoftimi i shpalljes sipas rezolutës 1373

B. Rishikimi i shpalljes, heqja nga lista dhe shkrirja.

III. ÇËSHTJET PAS SHPALLJES: NGRIRJA DHE NDALIMI E PËRDORIMIT TË FONDEVE OSE PASURIVE TË TJERA QË KANË TË BËJNË ME PERSONAT DHE SUBJEKTET E SHPALLURA.

A. Gama e fondeve dhe pasurive të tjera që janë subjekt i masave të ngrirjes.

B. Ngrirja “pa vonesë” e fondeve ose pasurive të tjera në procesin e shpalljes.

C. Strategjia e komunikimit

D. Raportimet dhe hetimet pas ngrirjes.

IV. PERSONAT DHE SUBJEKTET E SHPALLUR: PËRPUTHSHMËRIA DHE QASJA NË FONDET DHE PASURITË E TJERA TË NGRIRA.

A. Personat dhe subjektet rezident të shpallur

B. Autoritetet vendase dhe procedurat për të lejuar përdorimin ose transaksionet me fondet ose pasuri të tjera të ngrira ose vënien në dispozicion të fondeve ose pasurive të tjera për personat ose subjektet e shpallura.

SHKURTIMET

DNFBP	- Bizneset jo-financiare dhe profesionet e përcaktuara;
NjIF	- Njësi e Inteligjencës Financiare;
Sh6	- Shënimet Shpjeguese të Rekomandimit 6;
RTD	- Raportet e Transaksioneve të Dyshimta;
RKSKB	- Rezoluta e Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara;

HYRJE

1.Rekomandimi 6 (i FATF) i kërkon çdo vendi¹ që të zbatojë një kuadër sanksionesh specifike financiare në përputhje me RKSKB që kanë të bëjnë me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe financimit të tij. Rekomandimi 6 ka për qëllim ti ndihmojë vendet në zbatimin e sanksioneve specifike financiare² që bëjnë pjesë në RKSKB të lidhura me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit- (i) RKSKB 1267(1999) dhe rezolutat e saj pasardhëse (regjimet e sanksioneve të Al-Qaida/Taliban); (ii) RKSKB 1373(2001); dhe (iii) çdo RKSKB në vijim e cila vendos sanksione specifike financiare në kontekstin e financimit të terrorizmit. Këto rezoluta kërkojnë prej vendeve të ngrijnë, pa vonesë, fondet ose pasuritë e tjera dhe të sigurojnë që asnjë fond ose pasuri tjetër nuk vihet në dispozicion në mënyrë direkte apo indirekte, për ose për përfitimin e, çdo personi ose subjekti ekonomik (i) të shpallur nga³ ose sipas kompetencave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe në përputhje me regjimet e sanksioneve⁴ të Al-Qaidas/Taliban, ose (ii) të shpallur nga ai vend ose nga një juridiksion ndërkombëtar në përputhje me RKSKB 1373. Masa të tilla mund të jenë të natyrës juridike ose administrative.

¹ Të gjitha referencat për vendin apo vendet vlejné njëlloj për territoret apo juridiksionet.

² Termi sanksione financiare do të thotë ngrirje e pasurive dhe ndalimet për parandalimin e fondeve ose pasurive të tjera nga të qenit , direkt apo indirekt në dispozicion të personave dhe subjekteve të shpallur.

³ Termi personat apo subjektet e shpallur i referohet : (i) regjimeve të sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban, (a) individë, grupe, ndërmarrje dhe subjekte të shpallur nga Komiteti i Këshillit të Sigurisë i themeluar në përputhje me rezolutën 1267(1999) dhe 1989 (2011), si individë të lidhur me Al-Qaidan, ose subjekte, grupe të tjera dhe ndërmarrje të lidhura me Al-Qaidan (në kuadrin e sanksioneve të Al-Qaidas (1267/1989)) dhe (b) individë, grupe, ndërmarrje dhe subjekte të shpallura si talebanë para datës së miratimit të rezolutës 1988(2011), si dhe individë, grupe, ndërmarrje dhe subjekte të tjera të përcaktuara nga Komiteti i Këshillit të Sigurisë i themeluar në përputhje me rezolutën 1988(2011), si të lidhur me talebanët dhe që përbëjnë një kërcënim për paqen, stabilitetin dhe sigurinë e Afganistanit (kuadri i sanksioneve 1988) dhe (ii) për rezolutën 1373(2001), çdo person fizik apo juridik ose subjekt i shpallur nga vendet ose një juridiksion ndërkombëtar në bazë të rezolutës 1373(2001).

⁴ Rekomandimi 6 është i zbatueshëm për të gjitha rezolutat aktuale dhe të ardhshme të rezolutës 1267(1999), domethënë, ato rezoluta që zbatojné kuadrin e sanksioneve të Al-Qaidas (1267/1989) dhe ato rezoluta që zbatojné regjimin e sanksioneve 1988, dhe çdo RKSKB e ardhshme e cila vendos sanksionet financiare në kontekstin e financimit të terrorizmit. Në kohën e publikimit të praktikeve më të mira (Qershor 2013), dhe në funksion të ndarjes së kuadrit të sanksioneve të Al-Qaidas në 17 Qershor 2011, rezolutat pasardhëse të rezolutës 1267 (1999) janë: rezolutat 1333(2000), 1363(2001), 1390(2002), 1452(2002), 1455(2003), 1526(2004), 1617(2005), 1735(2006), 1822(2008), 1904(2009), 1989(2011) dhe 2083 (2012), dhe të gjitha rezolutat e tanishme dhe të ardhshme pasardhëse të rezolutës 1988 (2011), duke përfshirë 1730(2006) dhe 2082 (2012).

2. Elementët e kërkuar për një regjim specifik të sanksioneve financiare identifikohen në Rekomandimin 6 dhe në Sh6. Ndërkohë që Rekomandimi 6 do të jetë subjekti i vlerësimit reciprok të FATF, ky dokument, i cili zëvendëson dokumentin ekzistues të praktikave më të mira të publikuar në Tetor 2003 (i cili është rishikuar në Qershor të 2009), përcakton udhëzime jo detyruese bazuar në përditësimet përkatëse të RKSKB dhe në përgjigje të sfidave të hasura nga vendet në zbatimin e kërkesave të Rekomandimit 6.

3. Përpjekjet për të luftuar financimin e terrorizmit pengohen në një masë të konsiderueshme në rast se vendet nuk ngrijnë shpejt dhe në mënyrë efektive fondet ose pasuritë e tjera të personave⁵ dhe subjekteve të shpallura. Megjithatë, në përcaktimin e kufijve ose nxitjes së mbështetjes së gjerë për një regjim efektiv kundër financimit të terrorizmit, vendet duhet të respektojnë të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit, të lejojnë një proces të duhur, njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta në mirëbesim. Ky dokument synon të ndihmojë vendet në zhvillimin dhe zbatimin e sanksioneve specifike financiare për të parandaluar dhe goditur financimin e terrorizmit sipas RKSKB dhe në një mënyrë konsistente me këto parime thelbësore, përmes një regjimi të fortë dhe transparent të sanksioneve financiare të vendosura.

RËNDËSIA E NJË REGJIMI EFEKTIV BLOKIMI

4. Regjimi efektiv i ngrirjes, ka një rëndësi të veçantë si një mjet parandalues, në luftën kundër financimit të terrorizmit nëpërmjet të cilit tejkalohen rezultatet që arrihen me ngrirjen e fondeve apo pasurive të tjera që lidhen me terrorizmit në një kohë të caktuar. Gjithashtu regjimet efektive të ngrirjes luftojnë terrorizmin nëpërmjet:

- a) Pengimit të personave ose subjekteve të pa-shpallura, të cilët mund të jenë të gatshëm për të financuar veprimtari terroriste.
- b) Ekspozimit të “gjurmëve të parave” të financimit të terrorizmit që mund japin të dhëna për celula terroriste apo financues të tyre të pa njohur më parë.
- c) Shpërbërjes së rrjeteve të financimit të terrorizmit duke nxitur personat ose subjektet e shpallura të distancohen vetë nga aktivitetet terroriste dhe të heqin dorë nga bashkimi me grupe të tilla.
- d) Ndërprerjes së flukseve monetare të terroristëve duke mbyllur lidhjet e përdorura për lëvizjen e fondeve ose pasurive të lidhura me terroristët.

⁵ Fizik apo juridik

e) Detyrimet të terroristëve të përdorin mënyra më të kushtueshme dhe me një risk më të lartë në financimin e aktiviteteve të tyre, që i bënë ato më të ndjeshme ndaj zbulimit dhe ndalimit.

f) Nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përputhshmërinë me detyrimet sipas regjimeve të sanksioneve të Al-Qaida/Taliban dhe rezolutës 1373(2001).

I. AUTORITETET DHE PROCEDURAT E DUHURA PËR IDENTIFIKIMIN DHE SHPALLJEN E PERSONAVE OSE SUBJEKTEVE

A. SHPALLJA E PERSONAVE DHE SUBJEKTEVE

5. Për shpalljet sipas regjimit të sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban, Rekomandimi 6 ju kërkon vendeve të kenë autoritetin dhe procedurat ose mekanizmat efektive, për të identifikuar dhe iniciuar propozime për shpalljen e personave dhe subjekteve që i nënshtrohen rregjimit të sanksioneve të Al-Qaida/Taliban, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara⁶ dhe të sigurojnë masat mbrojtëse për të drejtat e personave dhe subjekteve të shpallura (shiko Seksionin II në vijim). Për sa i përket shpalljeve sipas rezolutës 1373 (2001), Rekomandimi 6 ju kërkon vendeve të kenë autoritetin dhe procedurat ose mekanizmat efektivë, për të identifikuar dhe iniciuar shpalljen e personave dhe subjekteve në përputhje me rezolutën 1373 dhe detyrimet e përcaktuara në të si dhe të sigurojnë masat mbrojtëse për të drejtat e personave dhe subjekteve të shpallura.

6. Zbatimi efektiv i këtyre masave kërkon mekanizma institucionale që mundësojnë një koordinim më të ngushtë mes autoriteteve financiare, të inteligjencës dhe të zbatimit të ligjit si dhe përfshirjen e këtyre masave në politikat kundër terrorizmit në shkallë vëndi.

Vendet duhet të përcaktojnë gjithashtu procedurat për të mbrojtur të gjitha burimet e informacionit, duke përfshirë materialet e inteligjencës dhe burimet e mbyllura, të përdorura në procesin e shpalljes së personave dhe subjekteve që i nënshtrohen masave të ngrirjes së pasurive.

⁶ Rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit nuk kërkojnë prej vendeve të identifikojnë personat apo subjektet dhe ta paraqesin këtë tek Komiteti përkatës i Kombeve të Bashkuara (për shembull Komiteti 1267 ose ai 1988), por të kenë autoritetin, procedurat dhe mekanizmat e duhura efektive, që të jenë në gjendje të veprojnë në këtë mënyrë.

B. MASAT GJYQËSORE OSE ADMINISTRATIVE TË PAKUSHTËZUARA NGA EKZISTENCA E PROCEDURAVE PENALE

PROCEDURAT PENALE

7. Autoritetet kompetente për fillimin apo realizimin e propozimeve për shpallje, mund të jenë administrative ose gjyqësore. Bazuar në kuadrin e sanksioneve të Al-Qaidas/Taleban, vendimi për propozimet nga shtetet anëtare për shpalljen merret ose nga Komiteti 1267 ose nga Komiteti 1988. Për rezolutën 1373(2001), shpalljet bëhen, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (*supranational*), nga një vend apo disa vende duke vepruar me inisiativën e tyre ose sipas kërkesës së një vendi tjetër, nëse vendi i cili merr kërkesën për shpalljen, krijon bindjen bazuar në parimet ligjore të zbatueshme për sanksionet specifike financiare, që një shpallje e kërkuar është e mbështetur në shkaqe ose baza të arsyeshme për të dyshuar ose besuar se personi i shpallur plotëson kriteret për listimin sipas rezolutës 1373(2001).⁷

Procedurat administrative, për shembull, përfshijnë një vendim të njëanshëm nga një përfaqësues i ekzekutivit bazuar në informacionin që i është dhënë dhe është publikuar në një dokument zyrtar të tillë si gazeta zyrtare. Vendimi do të jetë subjekt i masave mbrojtëse dhe i shqyrtimit sipas legjislacionit administrativ të vendit. Procedurat gjyqësore, për shembull, nënkuptojnë një mekanizëm ku çështja për shpalljen i paraqitet një autoriteti gjyqësor pa praninë e personave ose subjekteve që synohet të shpallen dhe ku veprimi i ngrirjes merr formën e një urdhri të ekzekutueshëm nga ky autoritet. Urdhëri i ngrirjes në procedurat administrative dhe ato gjyqësore duhet të ketë një kohëzgjatje të pacaktuar, përpos rasteve kur personi ose subjekti është hequr nga procedura si pasojë e një kundërshtimi të suksesshëm nga një palë e dëmtuar ose një rishikimi periodik të shpalljeve që bën vendi.⁸

8. Masat për të ngrirë fondet ose pasuri të tjera terroriste mund të plotësojnë procedurën penale kundrejt një personi ose subjekti të shpallur, por nuk janë të kushtëzuara nga ekzistenca e procedurave të tilla. Masat shërbejnë si një mjet parandalues apo shpërbërës kur procedurat e ndjkejes penale nuk janë të mundura apo praktike. Kjo sigurisht që nuk parandalon procedurat e ngrirjes dhe si e tillë përbën një pjesë të procedurave penale.

C. STANDARDET E PROVËS: SHKAQET OSE BAZAT E ARSYESHME

⁷ Shiko paragrafin 3 të Sh6 dhe Seksionin I.C Standardet dëshmuese: shkaqet ose bazat e arsyeshme të këtij punimi.

⁸ Në rastin e kuadrin të sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban, kërkesa për ngrirje zgjat për aq kohë sa personi apo subjekti i listuar mbetet në listën e sanksioneve të Al-Qaidas apo në atë të sanksioneve të 1988. Megjithëse, edhe nëse personi apo subjekti hiqet nga lista e sanksioneve të Al-Qaidas ose nga lista e sanksioneve të 1988, vendet mund të mbajnë të targetuara sanksionet financiare, duke përfshirë ngrirjen e pasurive dhe ndalimet e vazhdueshme, kundër personave apo subjekteve shqetësuese, nëse ato përcaktojnë që ata i përmbushin kriteret e përcaktuara në zbatim të detyrimeve sipas rezolutës 1373.

9. Për shpalljet sipas Rezolutës 1373(2001), autoriteti kompetent i çdo juridiksioni do të aplikojë standardet ligjore të sistemit të vet ligjor lidhur me llojin dhe sasinë e provave për të përcaktuar nëse “*shkaqet e arsyeshme*” ose “*bazat e arsyeshme*” ekzistojnë për një vendim për shpalljen e një individi ose subjekti, dhe kështu të nisë veprimin sipas një mekanizmi ngrirës. Ky proces ndërmerret pavarësisht nëse shpallja e propozuar është bërë me inisiativën e vëndit apo me kërkesë të një juridiksioni tjetër.⁹

10. Për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve dhe për të realizuar sa më shpejt përpunimin e kërkesave të huaja për shpallje, autoritetet përgjegjëse në të gjitha vendet inkurajohen për të komunikuar mes tyre mbi mënyrë se si zbatohet në vëndin e tyre standardi ligjor për shpalljet në përputhje me standardin e “*shkaqeve të arsyeshme*” ose “*bazave të arsyeshme*”, duke ofruar shembuj të llojit të informacionit që është i nevojshëm për të filluar këtë proces mbi bazën e një kërkesë nga një vend i huaj. Kjo do t’i mundësojë vëndit kërkuar të përshtasë kërkesën e tij për të përmbushur standardet e vëndit të cilit i drejtohet kërkesa.

D. INFORMACIONI IDENTIFIKUES

11. Identifikimi i informacionit është thelbësor, për një zbatim efektiv të ngrirjes së pasurive¹⁰.

12. Dobësitë e hasura në këtë proces janë një pengesë në ekzekutimin e ngrirjes së pasurive dhe identifikimi me një emër të vetëm përbën veçanërisht problem në drejtim të zbatimit.

13. Për këtë arsye përpjekje më të mira duhet të bëhen për të siguruar sa më shumë informacion që të jetë e mundur në kuadrin e shpalljes dhe që një informacion i tillë të përditësohet me të dhënat që sigurohen në vijim. Në varësi të veçorive operacionale juridiksionet mund të marrin në konsideratë shtyrjen e një shpallje deri në një moment të dytë derisa informacioni përkatës të jetë i mjaftueshëm.

E. AUTORITET PËR TË IDENTIFIKUAR, SHPALLUR DHE SANKSIONUAR

14. Në funksion të zbatimit të sanksioneve specifike financiare sipas Rekomandimit 6 përfshirë këtu inicimin apo propozimin për shpallje met, kërkohet angazhimi i një sërë autoritetesh (për shembull Punëve të Jashtme, Drejtësisë, Thesarit, Financës, Bankës Qendrore, Sigurisë së Brëndshme ose Publike) dhe agjensish (për shembull, sigurisë, inteligjencës, zbatimit të ligjit, NjIF).

⁹ Shiko paragrafin 4(d) të Sh 6.

¹⁰ Informacioni identifikues mund të përfshijë, por nuk kufizohet në : emra dhe drejtshkrime alternative, datën e lindjes, vendlindjen, adresën, kombësinë dhe numrat e pasaportës apo ID-isë.

15. Vendet duhet të kenë struktura dhe procedura të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të mekanizmave të ngrirjes së pasurive. Në këtë kontekst, vendet duhet:

a) Të identifikojnë agjensitë qeveritare me përgjegjësitë primare për :

(i) Koordinimin dhe kur është e nevojshme, nxitjen e zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve të ngrirjes së pasurive sipas rezolutës 1373(2001), kuadrit të sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban dhe kërkesave të Rekomandimit 6.

(ii) Të siguruar një proces të rregullt, të përbërë nga aktorë kyç të qeverisë për koordinimin e duhur (qoftë brënda vendit apo me vende të tjera), mbikëqyrjen dhe drejtimin strategjik të politikave për të nxitur procesin e zbatimit dhe kapërcyer pengesat që dalin në këtë proces.¹¹

b) Përcaktimin e qartë se cilat autoritetet përgjegjëse në çdo aspekt të procedurës së shpalljes sipas rezolutës 1373 (2001) ose kuadrit të sanksioneve ndaj Al-Qaidas/Taliban¹² dhe për vendosjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen në vijim të ngrirjes së pasurive, për të parandaluar mbivendosjen e roleve apo rregulloreve midis agjensive.¹³ Në këtë drejtim, vendet duhet të kenë në dispozicion një gamë sanksionesh efektive, proporcionale dhe bindëse, qoftë kriminale, civile ose administrative, të zbatueshme ndaj personave fizik ose juridik që nuk përmbushin këto kërkesa.

c) Të siguruar që Ministrinë dhe agjensitë e përfshira të kenë një qëndrim të përbashkët mbi mandatet, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me detyrimet e rezolutës 1373(2001) dhe kuadrin e sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban dhe kërkesave të Rekomandimit 6 dhe ndërmarrjen e shkëmbimit të rregullt të informacionit sipas ligjit vendas.

¹¹ Një proces i tillë mund të arrihet përmes proceseve të koordinimit aktual për aktivitetet që ndërveprojnë (si komitetet e koordinimit të gjerë kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (KPP/KFT)) ose nëpërmjet një procesi të dedikuar ndër-institucional.

¹² Paragrafi 18 i rezolutës 2082(2012) “ Nxit fuqimisht shtetet anëtare, që në kuadrin e shqyrtimit të një shpallje të re, të konsultohen me qeverinë e Afganistanit në përcaktimin e parë të dorëzimit në Komitetin 1988, për të siguruar koordinimin e përpjekjeve për paqe dhe bashkërendim me qeverinë e Afganistanit dhe të inkurajojë të gjithë vendet anëtare duke pasur parasysh propozimin e një përcaktimi të ri për të kërkuar këshilla nga MNKBA (Misioni Ndihmës i Kombeve të Bashkuara në Afganistan), kur është e përshtatshme”.

¹³ Në këtë drejtim, vlen për t'u theksuar që paragrafi 8 i rezolutës 1904(2009) inkurajon “ Shtetet anëtare të caktojnë një pikë kombëtare kontakti në lidhje me hyrjet në listën e konsoliduar”. Vendet mund ta konsiderojnë caktimin e një pike kombëtare kontakti në lidhje me hyrjet në të dyja si në listën e sanksioneve të Al-Qaidas dhe në listën e sanksioneve të 1988, veçanërisht pasi do të ketë nga momenti në moment ndryshime në listë. Pika kombëtare e kontaktit gjithashtu mund të lehtësojë komunikimin ndërmjet vendeve dhe Komiteteve të Sekretarisë/Sanksioneve të KB (për shembull Komiteti 1267 dhe ai 1988)/Ekipit Monitorues.

d) Krijimin e linjave të qarta të komunikimit midis këtyre Ministrive dhe agjensive (duke marrë në konsideratë kërkesat procedurale të procesit të hetimit) për të mundësuar një panoramë më të përgjithshme mbi gamën e mjeteve kundër terrorizmit, në dispozicion të vendit dhe efektivitetin e përdorimit të tyre në çdo situatë. Për shembull:

(i) Të sigurohet që ndërmjet agjensive të zbatimit të ligjit, të inteligjencës, financës dhe Ministrive të brendshme/jashtme të ketë akses në të gjitha informacionet për identifikimin e personave për shpallje.

(ii) Midis ministrive dhe agjensive në situatat ku një person shpallet si pasojë e procedimeve që kanë lidhje me veprat penale (për shembull, me ose menjëherë pas arrestimit për vepra terroriste, ose për një periudhë pas investigimeve së suksesshme për vepra terroriste dhe në pritje të veprimeve të mundshme të konfiskimit, ose të mbajtura gjatë ose pas një periudhe burgimi).¹⁴

F. IDENTIFIKIMI I SUBJEKTEVE PËR PROCESIN E SHPALLJES

16. Procesi shpalljes duhet të përqëndrohet te ata persona dhe subjekte që përfaqësojnë elementët kyç të një rrjeti mbështetës të terroristëve në mënyrë që të sigurohet efekti maksimal në parandalimin dhe goditjen e akteve terroriste.¹⁵

G. PËRDORIMI I MATERIALEVE TË INTELIGJENCËS DHE BURIMEVE TË MBYLLURA

17. Duke pasur parasysh rolin kritik që luan intelijenca në luftën kundër kërcënimeve terroriste, informacioni kryesor mbi të cilin bazohet shpallja e një personi apo subjekti sipas masave terroriste të ngrirjes së pasurive shpeshherë mund të jetë nga burime të inteligjencës.

18. Mbi bazën e sistemeve të tyre ligjore, shtetet duhet të marrin në konsideratë forcimin e autoriteteve ligjore dhe mekanizmave që lejojnë përdorimin dhe shpërndarjen e informacionit të shërbimeve të inteligjencës në lidhje me çdo rast që ka të bëjë me shpalljen, duke marrë parasysh nevojën për të zbatuar dhe vazhduar shpalljen, ose për të siguruar prova të mjaftueshme përpara një organi administrativ ose gjykatë në

¹⁴ Paragrafi 15 i rezolutës 2083(2012) inkurajon shtetet anëtare, organizatat dhe organet përkatëse ndërkombëtare të informojnë Komitetin 1267 për çdo vendim dhe procedurë gjyqësore kështu që Komiteti 1267 t'i marri ato në konsideratë kur të rishikojë me arsye listimin ose përditësimin përkatës në mbledhjen narrative.

¹⁵ Në lidhje me regjimet e sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban, procesi i targetuar për emërtimin duhet të akomodojë kriteret e listuara nga Këshilli i Sigurisë siç përcaktohet në paragrafin 2, 3 dhe 5 të rezolutës 2083(2012) dhe paragrafit 2, 3 dhe 4 të rezolutës 2082(2012).

rast se një shpallje e tillë do të ankimohej.¹⁶

19. Në lidhje me kërkesat e huaja për shpallje, këto mekanizma duhet të projektohen në atë mënyrë që t'i mundësojnë një vendi kërkues të sigurojë sa më shumë informacion që të asistojë vendin të cilit i është drejtuar kërkesa, në përmbushjen e standardeve të veta të provave për shpalljen.

20. Në varësi të vlerësimeve të zbatimit të ligjit të brëndshëm dhe çështjeve të sigurisë me karakter sensitiv, shtetet duhet që gjithashtu të marrin në konsideratë përcaktimin e masave për të përforcuar përdorimin e informacionit të shërbimeve të inteligjencës në gjykatë në rastet kur është e nevojshme të mbrohen vendimet e shpalljes si dhe për të ruajtur në mënyrë të përshtatshme informacionin sensitiv.

21. Këto mekanizma duhet të respektojnë të drejtat e një personi apo subjekti të shpallur dhe të sigurojnë një proces të duhur, në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar.

H. KUPTIMI I TERMIT “MENJËHERË” NË KONTEKSTIN E SHPALLJEVE

22. Detyrimi që referohet në Rekomandimin 6, është për ngrirjen e menjëhershme të fondeve dhe pasurive të tjera të personave dhe subjekteve të shpalluara. Në lidhje me kuadrin e sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban, fjalori i Rekomandimeve të FATF, përcakton që menjëherë dhe pa vonesë do të nënkuptonte në mënyrë ideale brënda disa orësh nga shpallja prej Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara ose sanksionet Komitetit të tij përkatës (p.sh Komiteti 1267, ose Komiteti 1988). Për qëllime të rezolutës 1373(2001), menjëherë dhe pa vonesë, nënkupton kohën gjatë së cilës sigurohen shkaqet ose bazat e arsyeshme për të pasur, dyshuar ose besuar që një person apo subjekt është terrorist, financon terrorizmin ose është organizatë terroriste.¹⁷

Në te dyja rastet, menjëherë dhe pa vonesë duhet të interpretohet në kontekstin e nevojës për të parandaluar nxjerrjen ose shpërndarjen e

¹⁶ Paragrafi 23 i rezolutës 2083 “ Nxit fuqimisht shtetet anëtare të sigurojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për Avokatin e Popullit, duke përfshirë çdo informacion konfidencial, kur është e përshtatshme, mirëpritjen e atyre marrëveshjeve kombëtare të ndërmarra nga shtetet anëtare me Zyrën e Avokatit të Popullit për të lehtësuar ndarjen e informacionit konfidencial, inkurajon më tej bashkëpunimin e shtetet anëtare në këtë drejtim, dhe konfirmon se Avokati i Popullit duhet të pajtohet me çdo kufizim konfidencialiteti që është pjesë e informacioneve të tilla të siguruar nga shtetet anëtare”. Shikoni gjithashtu faqen e internetit të Zyrës së Avokatit të Popullit (<http://www.un.org/en/sc/ombudsperson/acesinfo.shtml>).

¹⁷ Kriteri i saktë për përcaktimin sipas rezolutës 1373 trajtohet në seksionin E të SH6.

fondeve ose pasurive të tjera të cilat janë të lidhura me terroristët, organizatat terroriste dhe ata të cilët financojnë terrorizmin dhe nevojën e përbashkët për veprim global për të ndaluar dhe penguar me shpejtësi transferimin e tyre.

23. Për të lehtësuar ngrirjen pa vonesë, sa herë që është e mundur, një vend duhet të synojë të paralajmërojë vendet e tjera, nëse ka gjasa që pasuritë e një personi ose subjekti të shpallur mund të gjënden atje.

II. PROCESI I DUHUR: RISHIKIMI, HEQJA NGA LISTA DHE ZHBLLOKIMI

A. NJOFTIMI I SHPALLJES SIPAS REZOLUTËS 1373¹⁸

24. Vendi i shpalljes dhe vendi i rezidencës duhet të kryejë të gjitha përpjekjet e arsyeshme (kur është e përshtatshme ose e mundur), brënda një kohe sa më të shpejtë pas hyrjes në fuqi të shpalljes, për të informuar direkt personat dhe subjektet e shpallura për:

- a) Shpalljen dhe pasojat e saj, në mënyrë që të parandalojnë çdo shkelje të paqëllimshme nga ana e tyre ose në lidhje me palët e treta.
- b) Procedurën e rishikimit dhe informacionin mbi procesin e heqjes nga lista, duke përfshirë një pikë kontakti brënda qeverisë për të trajtuar çdo pyetje në këtë drejtim.
- c) Informacionin e publikueshëm në lidhje me arsyet e shpalljes.
- d) Procedurat për të lejuar të drejtën e përdorimit të fondeve në përputhje me rezolutën 1452(2002) dhe rezoluta të ngjashme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shpenzimet bazë dhe të jashtëzakonshme sa më shpejt të jetë e mundur.¹⁹

¹⁸ Në lidhje me kuadrin e sanksioneve të Al-Qaidas/Taliban, paragrafi 17 i rezolutës 1822(2008) kërkon që “Shtetet anëtare të marrin njoftimin (për shpalljen)..., në përputhje me ligjin dhe praktikën e tyre të brendshme, të marrë të gjitha masat e mundshme për të njoftuar ose informuar në kohën e duhur individët apo subjektet e listuara për shpalljen dhe të përfshijë në këtë njoftim një kopje të pjesës publike të pasqyrës së rastit, çdo informacion në dispozicion mbi arsyet e listimit, e vendosur në faqen e internetit, një përshkrim të efekteve të shpalljes, siç përcaktohet në rezolutën përkatëse, procedurat e Komitetit për marrjen në konsideratë kërkesat për heqjen nga lista dhe dispozitat e rezolutës 1452(2002) në lidhje me përjashtimet”. Paragrafi 18 i rezolutës 2083(2012) kërkon prej shteteve anëtare “të përfshijnë në këtë njoftim (për shpalljen përcaktimin) përmbledhjen e arsyeve të listimit”. Përmbledhjet e arsyeve për listimin publikohen në faqen e internetit të Komitetit 1267 (<http://www.un.org/sc/committees/1267/narrative.shtml>) dhe të Komitetit 1988 (<http://www.un.org/sc/committees/1988/narrative.shtml>). Shiko paragrafin 11 të Sh6.

¹⁹ Lidhur me aksesin ndaj fondeve ose pasurive të tjera të ngrira, shiko në paragrafin 10 të Sh6 dhe Seksioni IV.B të këtij dokumenti.

B. RISHIKIMI I SHPALLJES, HEQJES NGA LISTA DHE ZHBLLOKIMIT.

1. Ekzistenca dhe zbatimi në kohën e duhur i procedurave për rishikimin e shpalljeve sipas rezolutës 1373, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
25. Për rishikimin e shpalljeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar sipas rezolutës 1373(2001), paragrafi 8 i Sh6 ju kërkon vendeve të kenë autoritetin ligjor dhe procedurat/mekanizmat për heqjen nga lista dhe zhbllokimin e fondeve ose pasurive të tjera të personave dhe subjekteve që nuk plotësojnë kriteret për shpallje sipas rezolutës 1373, dhe të kenë gjithashtu procedurat për të lejuar rishikimin e vendimit të shpalljes përpara një gjykate apo autoriteteve të tjera të pavarura.
26. Për të siguruar drejtësi në procedurat administrative dhe ligjore për ngrirjen e pasurive, vendet duhet të marrin masa që çdo person ose subjekt në përputhje me parimet e përgjithshme ligjore të vendit, të ketë të drejtën të kërkojë një rishikim të shpalljes nga autoriteti përkatës, përpara një gjykate ose autoriteti tjetër të pavarur.
27. Autoriteti që bën shpalljen dhe personi ose subjekti i shpallur duhet të kenë të drejtën të bëjnë kërkesa pranë një organi rishqyrtues. Në përputhje me parimet themelore të sistemit juridik të vendit seanca e rishqyrtimit bëhet pasi të jenë marrë në konsideratë të dhënat që paraqesin palët. Në varësi të gjykimit të organit kompetent seanca mund të jetë publike ose të mbyllura.
28. Vendimet përfundimtare të organit rishqyrtues duhet të jenë publike, por organi rishqyrtues duhet të ketë mundësinë e mos bërjes publike të konstatimeve tij, nëqë ai vlerëson se ndonjë aspekt nga akti vendimi mund të prekë të drejtën e konfidencialitetit apo çështjen e sigurisë, ose me propozimin e autoritetit që bën shpalljen apo të një kandidati për rishqyrtim. Përjashtime të tilla duhet të marrin në konsideratë të drejtat e një personi ose subjekti të caktuar ose palët e treta të prekura sipas ligjeve të brëndshme dhe politikave që lidhen me transparencën në vendimmarrje.
29. Publikimi i vendimeve të organeve rishqyrtuese do të lejojë zhvillimin e një jurisprudence, e cila, nga ana tjetër, do të ndihmojë në përmirësimin e marrjes së vendimeve parësore, me synimin për të zvogëluar nevojën e rishikimit të këtyre vendimeve. Publikimi gjithashtu mund të jetë një mjet për të tërhequr vëmendjen e sektorit privat ndaj ndryshimeve apo azhurnimeve në listën e personave dhe subjekteve të shpallur si rezultat i rishqyrtimit të vendimeve.
30. Një person ose subjekt i shpallur duhet gjithashtu të jetë në gjendje të aplikojë përsëri për një rishqyrtim në mënyrë periodike, nëse kërkesat e tyre fillestare kanë dalë të pasuksesshme.
31. Vendet duhet të marrin në konsideratë zbatimin e procedurave për rishqyrtimin periodik të shpalljeve, mbi bazën e një informacion të ri të bërë të njohur në lidhje me shpalljen ose një kërkesë për rishikim nga një vend i ndikuar nga shpallja.

2. Procedurat përshtatshme për të lehtësuar rishikimin e shpalljeve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) në kuadrin e sanksioneve ndaj Al-Qaida/Taliban.

32. Vendet duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë procedura të njohura publikisht për ti paraqitur kërkesa delistimi Këshillit të Sigurimit në rastin e personave dhe subjekteve të shpallura në kuadrin e sanksioneve të Al-Kaida/Taliban, të cilët nga pikëpamja e një vendi, nuk plotësojnë më kriteret për një shpallje të tillë. Për sanksionet e Al-Kaidës (1267/1989), të tilla procedura dhe kriteret duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e zbatueshme apo procedurat e miratuara nga Komiteti 1267. Në rast mospranimi për përcaktim të cilat janë bërë nga Avokati i Popullit (Ombudsperson) nëpërmjet procesit të rezolutave 1267 (1999), 1904 (2009), 1989 (2011) dhe 2083 (2012), vendet mund të shqyrtojnë mundësinë e krijimit të kanaleve për shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë informacionet konfidenciale, me Avokatin e Popullit. Për sanksionet sipas rezolutës 1988, procedurat dhe kriteret duhet të jenë në përputhje me udhëzimet apo procedurat e miratuara nga Komiteti 1988, duke përfshirë ato të mekanizmit të Pikës së Kontaktit të vendosura sipas Rezolutës 1730 (2006).

3. Heqja nga lista dhe zhblllokimi sipas Rezolutës 1373 dhe sanksioneve të Al-Kaida/Taliban

33. Për personat dhe subjektet e shpallura sipas Rezolutës 1373 (2001), shtetet duhet të kenë autoritetin e duhur ligjor dhe procedura apo mekanizma për të hequr nga lista, zhbllokuar fondet ose pasuritë e tjera si dhe të shfuqizuar sanksionet kundër atyre palëve për të cilët ekziston bindja se nuk plotësojnë më kushtet për shpallje.

34. Për ato persona dhe subjekte të shpallur në kuadrin e sanksioneve të Al-Qaida/Taliban, shtetet duhet të kenë autoritetin e duhur ligjor dhe procedura për zhblokimin e fondeve ose pasurive të tjera, dhe për të hequr kushtet e sanksioneve kundër atyre palëve që kanë janë hequr nga lista nga Komiteti 1267 ose Komiteti 1988. Megjithatë, edhe në qoftë se personi apo subjekti është larguar nga lista e sanksioneve të Al-Qaida ose nga lista e sanksioneve të Komitetit 1988, vendet mund të zbatojnë sanksione të veçanta financiare, duke përfshirë bllokimin e pasurive dhe ndalimeve në vijimësi kundrejt personave ose subjekteve të shpallur, nëse ato mendojnë se përmbushen kushtet për shpallje në përputhje me detyrimet sipas Rezolutës 1373.

III. ÇËSHTJET PAS SHPALLJES: BLOKIMI DHE NDALIMI I TRANSAKSIONEVE ME FONDET OSE PASURITË E TJERA TË PERSONAVE DHE ENTITETEVE TË SHPALLUR

A. SFERA E FONDEVE OSE PASURIVE TË TJERA QË JU NËNSHTROHEN MASAVE TE NGRIRJES

35. Detyrimi i shprehur në rezolutën 1373 (2001) dhe kuadrin të sanksioneve të Al-Qaida/Taliban edhe kërkesat e Rekomandimit 6 për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera, janë përkufizuar në Fjalorin e Rekomandimeve të FATF për të mbuluar çdo pasuri, duke përfshirë por pa u kufizuar në, pasuritë financiare, burimet ekonomike, pronë e çdo lloji, të luajtshme apo të paluejtshme, pavarësisht mënyrë së sigurimit dhe dokumentet ose instrumentet ligjore të çfarëdo forme, duke përfshirë ato elektronike ose dixhitale, evidentimi i titujve, ose interesin në këto fonde dhe pasuri të tjera, duke përfshirë, por jo kufizuar në, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksione, siguracione, obligacione, urdhërpagesa, apo letrat e kreditit, dhe çfarëdo interesi, pjesë nga fitimi i kompanive apo të ardhura të tjera mbi të cilat vlera shtohet ose gjenerohet nga fonde apo pasuri të tjera.

36. Vendet duhet të sigurojnë që, nëse mekanizmi i tyre i ngrirjes të pasurive është ngritur në një mënyrë që e bazon aftësinë për të bllokuar mbi një përkufizim të terrorizmit apo financimit të terrorizmit në legjislacionin e brëndshëm penal, përkufizimet e tilla janë mjaft gjithëpërfshirëse për të mbuluar një ngrirje të të gjitha fondeve ose pasurive të tjera të çdo personi apo subjekti të shpallur në kuadrin e sanksioneve të Al-Qaida/Taliban dhe rezolutës 1373.

37. Vendet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mirëmbajtjen e regjistrave të titujve të llojeve të veçanta të pronës nga autoritetet qeveritare, apo ata që janë përgjegjës për lëvizimin e fondeve ose të pasurive të tjera, të jenë në dijeni të veprimit për bllokimin e pasurive dhe të marrin masat e duhura për të zbatuar detyrimin sipas ligjit vëndas.

B. BLOKIMI PA VONESË E FONDEVE OSE PASURIVE TË TJERA TË SHPALLURA

38. Bllokimi duhet të kryhet pa vonesë. Megjithatë, publikimi i veprimit nuk duhet të bëhet ndërkohë që bllokimi është akoma në fuqi, pavarësisht nëse shpallja është bërë nga një vend me propozimin e vet ose me pranimin e një kërkesë shpalljeje nga një vend tjetër.

C. STRATEGJIA E KOMUNIKIMIT

39. Zbatimi efektiv i detyrimit të ngrirjes të pasurive kërkon një strategji efikase dhe efektive të komunikimit. Përderisa sektorit privat i është kërkuar ligjërisht nga legjislacioni përkatës të jetë në përputhje me detyrimet e ngrirjes të pasurive, vendet duhet të jenë të vetëdijshme për ndikimin që përputhshmëria ligjore ka në aktivitetet e tyre të biznesit dhe të synojnë, aq sa të jetë e mundur, të minimizojnë kostot e këtij procesi.

40. Kërkesat duhet të jenë përcaktuara qartë për sektorin privat, sipas paragrafi 6(c) të Sh6. Kjo duhet të përfshijë jo vetëm institucionet financiare, por edhe bizneset dhe profesionet jofinanciare (DNFBP) dhe sektorët me rrezik të lartë që nuk mund të kenë pasur të bëjnë me masat e bllokimit të pasurive, të tilla si organizatat jo-fitimprurëse (OJF).

1. Objekti i strategjisë së komunikimit

41. Detyrimet e rezolutës 1373 (2001) për ngrirjen e pasurive dhe kuadri i sanksioneve Al-Kaida/Taliban, bazuar në legjislacionin përkatës, janë të zbatueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë në vend. Strategjia e komunikimit duhet, si pasojë të;

- a) Përfshijë metoda efikase dhe efektive për të informuar sektorin privat dhe publikun në përgjithësi për detyrimet e tyre në kuadrin e mekanizmit të ngrirjes të pasurive;
- b) Sigurojë udhëzime të qarta për të gjithë personat dhe subjektet që kanë gjasa të mbajnë fonde apo pasuri të tjera, të cilat përfshijnë por pa u kufizuar në institucionet financiare;
- c) Përfshijë metoda efikase dhe efektive për informimin e sektorëve me rrezik të lartë dhe DNFBP për detyrimet e tyre nën mekanizmin e ngrirjes së pasurive; dhe,
- d) Mund të përfshij angazhimin e niveleve të larta me organet përkatëse që përfaqësojnë bizneset, industrinë dhe sektorët me rrezik të lartë, si dhe më shumë angazhim jozyrtar me institucionet dhe sektorëve individual.

2. Përmbajtja e mesazhit

42. Strategjia e komunikimit duhet të sigurojë shpërndarjen në kohë dhe në shkallë të gjërë publike të:

- a) Ekzistencës së kufizimeve për bllokimin e pasurive dhe detyrimet me të cilat ngarkon sektorin privat brënda vendit (të identifikojnë, bllokojnë, të sigurojnë që asnjë nga fondet dhe pasuritë e tjera nuk janë në dispozicion dhe të raportojnë fonde apo pasuri të tjera të lidhura, që më pas të ndalojnë marrëveshjet e pa licensuara të personave dhe subjekteve të shpallur, për të vazhduar kontrollin mbi transaksionet që lidhen me personin ose subjektin e shpallur dhe veprimet që duhet të ndërmerren nëse zbulohen fondet, pasuri të tjera ose transaksionet të dyshimta).
- b) Dobishmërisë së një mekanizmi për bllokimin e pasurive si një mjet parandalues për të penguar mbështetjen dhe veprimtaritë terroriste dhe rëndësinë e të vepruarit në përputhje me detyrimet e bllokimit të pasurive (duke nënvizuar pasojat civile dhe penale që lindin nga papajtueshmëria, si dhe risqet e reputacionit për institucionet financiare dhe DNFBPs për të cilat evidentohen shkelje).
- c) Informimit mbi identifikimin e të gjithë personave dhe subjekteve që i nënshtrohen mekanizmit të ngrirjes të pasurive (të gjitha informatat aktuale të përcaktuara sipas Rezolutës 1373 (2001) si dhe regjimit të sanksioneve të Al-Kaida/Talibanë), përmes publikimit të një listë të plotë të të gjithë këtyre personave dhe subjekteve.
- d) Veprimet e ndërmarra në kuadrin e mekanizmit të ngrirjes të pasurive. Njoftimi ligjor i një vendimi mbi shpalljen (qofte për ato të reja apo dhe revokimet) duhet të konsiderohen si faza e parë e kësaj strategjie komunikimi.
- e) Pika kontakti të qarta brënda qeverisë ku sektori privat mund të drejtojë kërkesat për informacion, duke përfshirë një mekanizëm të cilit sektori privat, pas kryerjes së vigjilencës së duhur, mund t'i kërkojë udhëzime mbi ngjashmëritë e mundshme të personave dhe subjekteve të shpallur.

3. Mënyrat për përcjelljen e mesazhit

43. Vendet duhet të konsiderojnë mbajtjen e një faqe interneti të qeverisë të përditësuar dhe me informacion të plotë mbi:

- a) Procedurën e shpalljes dhe mekanizmin e ngrirjes të pasurisë.
- b) Tekstet e ligjeve përkatëse.

c) Listën e plotë e të gjithë personave dhe subjekteve që aktualisht janë subjekt i mekanizmit të ngrirjes së pasurive.

ç) Pikë kontakti për informacionet publike.

44. Vendet duhet të shqyrtojnë zbatimin e një shërbimi abonimi elektronik për personat dhe organizatat me një nevojë të caktuar, për tu informuar mbi vendimet e shpalljeve apo të revokimeve të tillë si sektori financiar, DNFBP dhe industrinë me rrezik të lartë.

D. RAPORTIMI PAS NGRIRJES DHE HETIMI

1. Cilësia dhe dobishmëria e të dhënave

45. Duke pasur parasysh shkallën e lartë të transaksioneve të mbuluara nga një ngrirje e pasurive dhe numrin e konsiderueshëm të personave dhe subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, është e rëndësishme që sektori privat të sigurojë përputhshmëri me një veprim ngrirjeje të pasurive. Vështirësia më e madhe ka të bëjë me identifikimin e një personi ose subjekti në listën e sanksioneve gjë që përbën dhe detyrën më të rëndësishme të sektorit privat në funksion të sigurimit të pajtueshmërisë. Kjo jo vetëm që krijon jo efikasitet dhe zgjat kohën që mund të marrë për të zbuluar shkeljet, por edhe zvogëlon vullnetin e mirë të sektorit privat në zbatimin e masave. Gjeneralitetet me cilësi të dobët rrisin barrën e pajtueshmërisë për bizneset dhe kanë një efekt të ngjashëm në zbatimin e ligjit.

46. Për këtë arsye, vendet duhet të shqyrtojnë dhe përditësojnë rregullisht listën e personave dhe subjekteve që i nënshtrohen masave të ngrirjes së pasurive, për të siguruar kështu listën me gjeneralitete të saktë dhe të përditësuar për personat e listuar sipas rezolutës 1373 (2001) ose regjimit të sanksioneve Al-Kaida/Taliban. Vendet me të dhëna shtesë për identifikimin e personave ose subjekteve të listuara nën regjimin e sanksioneve të Al-Kaidës (1267/1989) duhet të bëjnë të mundur që ato të dhëna të vihen në dispozicion të Komitetit 1267 për një ndryshim të mundshëm në listën e Al-Kaidës. Për ndryshimet e mundshme në Listën e Sanksioneve 1988, vendet duhet ti vendosin të dhënat në fjalë në dispozicion të Komitetit 1988.

2. Raportimi i ngjashmërive dhe zgjidhja e atyre që rezultojnë të rreme

47. Vendet që kanë mekanizma të ngrirjes së pasurive, të cilat kërkojnë raportimin e ngjashmërive të mundshme, duhet, së pari të inkurajohen që të marrin masa të arsyeshme për të vërtetuar saktësinë e ndonjë lidhjeje me listat para se të bëjnë raportimin e tyre tek autoriteti përkatës. Në rrethanat kur njësia raportuese nuk plotëson pragun ligjor për të ngrirë fondet ose pasuritë e tjera (dhe raporton te autoritetet kompetente), vendet duhet ti kërkojnë njësisë raportuese ti dërgojë FIU-t një raport të dyshimtë transaksioni (RAD).

48. Vendet duhet të asistojnë sektorin privat në identifikimin e ngjashmërive të rreme përmes publikimit të një udhëzuesi për të përcaktuar nëse një ngjashmëri potenciale është e saktë dhe duke siguruar vënien në punë të një pikë të qartë kontakti për të ndihmuar në rastet e pasigurisë.

Ngjashmëritë e rreme janë lidhje të mundshme të personave dhe subjekteve të listuara, për shkak të natyrës së përbashkët të emrit ose për shkak të të dhënave të paqarta mbi identifikimin, i cili pas analizimit mund të rezultojë i pasaktë.

3. Sigurimi i përputhshmërisë adekuate, kontrollet dhe raportimi në sektorin privat

49. Vendet duhet të punojnë me sektorin privat në zhvillimin e praktikave të mëposhtme: (i) për të lehtësuar bashkëpunimin dhe përputhshmërinë nga ana e sektorit privat në identifikimin dhe ngrirjen e fondeve ose pasurive të tjera të personave dhe subjekteve të shpallur, dhe (ii) për parandalimin e personave dhe subjekteve të shpallur nga kryerja e transaksioneve, brënda territorit të tyre apo përmes institucioneve të tyre financiare:

- a) Të bashkëpunojnë me sektorin privat në përgjithësi, duke përfshirë DNFBP dhe institucionet financiare në veçanti, sidomos ato që zbatojnë në mënyrë të pavarur programet për të parandaluar veprimtaritë potenciale të financimit të terrorizmit ose ato subjekte të cilat kanë paraqitur informacione potencialisht të dënueshme nga pikëpamja penale, në hetimin e një aktiviteti financiar të mundshëm nga një person ose entitet i shpallur;
- b) Të sigurojnë që institucionet financiare dhe DNFBP zhvillojnë dhe mbajnë kontrolle të brëndshme adekuate (duke përfshirë edhe procedurat e vigjilencës së duhur dhe programet e përshtatshme trajnuese) për të identifikuar llogaritë ekzistuese, transaksionet, fondet ose pasuritë e tjera të personave dhe subjekteve të shpallur;
- c) Të sigurojnë që institucionet financiare dhe DNFBP-të mund të ngrijnë menjëherë të gjitha fondet e identifikuara apo pasuritë e tjera të mbajtura apo të kontrolluara nga persona dhe subjekte të caktuar;
- d) Të sigurojnë që institucionet financiare dhe DNFBP-të kanë procedurat dhe burimet e duhura për të përmbushur detyrimet e tyre sipas Rekomandimit 6;
- e) Të sigurojnë që institucionet financiare dhe DNFBP-të zbatojnë procedurat e duhura për të parandaluar personat dhe subjektet e shpallur të kryejnë transaksione me ato, ose nëpërmjet tyre;
- f) Të zhvillojnë një sistem efektiv mbikëqyrjeje nga një autoritet kompetent ose një gjykatë me përvojë të mjaftueshme, autoritet mbikëqyrës dhe burime me një mandat për të mbështetur objektivat e përcaktuara në nën-paragrafët (b), (c) dhe (d) më sipër;
- g) Të nxisin, institucionet financiare dhe DNFBP, për aq sa është e arsyeshme, për të kërkuar ose shqyrtuar veprimtarinë e mëparshme financiare të personave dhe subjekteve të shpallur;

- h) Të identifikojnë, vlerësojnë pajtueshmërinë me të, dhe të përmirësojnë rregullat për identifikimin e klientit dhe kërkesat e mbajtjes së të dhënave të përdorura nga institucionet financiare dhe DNFBP;
- i) Të miratojnë masat e arsyeshme për të shqyrtuar të dhënat mbi pronarët përfitues, nënshkruesit dhe kompetencat e avokatit në lidhje me llogaritë ose transaksionet e mbajtura nga institucionet financiare ose DNFBP në rastet kur kërkojnë për veprimtari nga persona apo subjekte të shpallur duke përfshirë çfarëdo marrëdhënie biznesi në proces;
- j) Të harmonizojnë kontrollin e brëndshëm, kundër financimit të terrorizmit brënda secilit sektor ekonomik, me programet kundër pastrimit të parave.

50. Për çdo lloj DNFBP, duhet të ketë mekanizma për monitorimin dhe sigurimin e pajtueshmërisë me mekanizmat e ngrirjes së pasurive, për shembull nëpërmjet caktimit të përgjegjësive tek autoritetet kompetente përkatëse ose te pronarët.

IV. PERSONAT DHE SUBJEKTET E SHPALLUR: PAJTUESHMËRIA DHE QASJA NË FONDET E NGRIRA APO PASURITË E TJERA

A. SHPALLJA E PERSONAVE DHE SUBJEKTEVE REZIDENTË

51. Në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria me kërkesat për të bërë përjashtime për qasjen në fondet e ngrira apo pasuritë e tjera për shpenzime themelore apo të jashtëzakonta siç është përcaktuar në rezolutën 1452 (2002) ndërkohë që bëhet i mundur zbatimi i ngrirjes së pasurive, duhet të ndërtohen marrëdhënie të forta e të qëndrueshme dhe procese të fuqishme ndër-institucionale. Në këtë kuadër duhet të ketë:

- a) Komunikim midis autoriteteve kompetente (duke përfshirë, në se duhet, shërbimet e prokurorisë apo autoritete të tjera gjyqësore, shërbimi policor ose agjencitë e zbulimit) për të siguruar monitorimin e përputhjes të plotë me kushtet e ngrirjes së pasurive.
- b) Bashkërendim ndërmjet autoriteteve kompetente dhe institucioneve të mirëqenies sociale që sigurojnë mbështetje për një person rezident të shpallur dhe familjen e tij.

B. AUTORITETET E DUHURA TË BRËNDSHME DHE PROCEDURAT PËR AUTORIZIMIN E PËRDORIMIT TË FONDET E NGRIRA OSE PASURIVE TË TJERA APO VËNIEN E FONDEVE OSE PASURIVE TË TJERA NË DISPOZICION TË PERSONAVE APO SUBJEKTEVE TË SHPALLUR

52. Detyrimet e ngrirjes së pasurive nën kuadrin e sanksioneve të Al-Qaida/Taliban parashikojnë përjashtimet që bëhen për ngrirjen e pasurive kur është e nevojshme në rrethana të veçanta, siç përcaktohet në rezolutën 1452 (2002), e ndryshuar me rezolutën 1735 (2006). Paragrafi 1 i

rezolutës 1452 parashikon se “dispozitat e paragrafit 4 (b) të rezolutës 1267 (1999), dhe paragrafët 1 dhe 2 (a) të rezolutës 1390 (2002), nuk zbatohen për fondet dhe pasuritë e tjera financiare ose burimet ekonomike që janë të përcaktuara nga vendi (e) përkatës (e) të jenë;

a) të nevojshme për shpenzimet minimale jetësore, duke përfshirë këtu pagesat për ushqimet, qeranë ose hipotekën, barnat dhe trajtimet mjekësore, taksat, primet e sigurimit, dhe pagesat e shërbimeve publike, ose ekskluzivisht për pagesat e tarifave të arsyeshme profesionale dhe rimbursimin e shpenzimeve të shkaktuara nga shërbimet ligjore, apo tarifat ose pagesat e shërbimeve për mbajtjen ose mirëmbajtjen e zakonshme të fondeve të ngrira apo pasurive të tjera financiare ose burimeve ekonomike, pas njoftimit nga shteti (et) përkatës (e) i Komitetit [1267 ose 1988] ... me synimin për të autorizuar brënda 48 orëve, qasjen në fonde të tilla, burimet ose pasuritë;

b) të nevojshme për shpenzime të veçanta, me kusht që një përcaktim i tillë të jetë njoftuar nga Shteti(et) përkatës(e) Komiteti [1267 ose 1988] dhe të jetë miratuar nga Komiteti [1267 ose 1988].”

53. Paragrafi 5 i Rezolutës 1452 gjithashtu u kërkon Shteteve Anëtare ti marrin plotësisht parasysh këto konsiderata (si psh: përjashtimet e përcaktuara në Rezolutën 1452), në zbatimin e tyre të Rezolutës 1373 (2001).

54. Në rastet kur fondet apo pasuri të tjera kanë qenë të ngrira në kuadrin e sanksioneve të Al-Kaida/Taliban ose në bazë të Rezolutës 1373, duhet të përcaktohet një proces i qartë për të siguruar në se është e nevojshme, shqyrtimin, autorizimin dhe lejimin në mënyrë të shpejtë të kërkesave për përjashtime. Procedurat e vendimmarrjes efektive në nivel vendor duhet të mbështeten në procedura efektive për marrjen e miratimit nga Komisionet përkatëse të Këshillit të Sigurimit, (Rezolutat 1267/1989 dhe Rezoluta 1988).

55. Kuadri autorizues ka nevojë të vendosë një ekuilibër mes:

a) Të kuptuarit e qëllimit për të cilin është dhënë autorizimi (shpenzime themelore, shpenzime të veçanta, pagesat kontraktuale apo për arsye të tjera të autorizuara).

b) Zvogëlimin e rreziqeve të pagesave të autorizuara që shkojnë për qëllime të tjera përveç atyre për të cilat është dhënë autorizimi, duke përfshirë qëllimet terroriste.

c) Minimizimin e ngarkesës për sektorin financiar.

d) Funkcionimin e ligjit vendas.

56. Ky proces duhet të administrohet me kujdes për tu siguruar që zbatimi i tij është i qëndrueshëm, transparent, i arsyeshëm dhe proporcional,

me një gjurmë auditimi të qartë për arsyen e autorizimit dhe vendimmarrjen mbi kushtet e vendosura në lidhje me përjashtimin.

57. Vendet duhet të zbatojnë kontrollet e duhura për dhënien e autorizimeve për të siguruar zbatimin e duhur, përmbushjen e kushteve për përjashtimin dhe mos lejimin e përdorimit të fondeve apo pasurive për qëllime të tjera (përfshirë ato terroriste).